

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2018 PËR PROJEKTIN “PROGRAMI SEKTORIAL I UJËRAVE/ FURNIZIMI ME UJË I ZONAVE RURALE IV””

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018, për projektin “Programi sektorial i ujërave/ Furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

Këto financime, që priten të akordohen nga KFW-ja në kuadër të fazës së katërt të projektit “Furnizimi me ujë i zonave rurale” do të përdoren për realizimin e investimeve në zonën bregdetare të jugut të Shqipërisë, duke u fokusuar në Bashkinë e Himarës dhe në Bashkinë Orikum.

Qëllimi i projektit “Furnizimi me ujë i zonave rurale IV” është përmirësimi i infrastrukturës së ujësjellësve dhe kanalizimeve, nëpërmjet sigurimit të qëndrueshëm në furnizimin me ujë të pijshëm për popullësinë rezidente dhe turistët në zonën e projektit, me kosto sociale të pranueshme dhe tarifa që i mbulojnë kostot, si dhe të saniteteve të përshtatshme, nëpërmjet sistemit të kanalizimeve, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe përmirësimit të kapaciteteve menaxhuese.

Zbatimi i këtij projekti do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe do të promovojë zhvillimin e turizmit në zonën e projektit, duke e çuar numrin e përtituesve në 80 000 përfitues, përfshirë turistët.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV, i përgjigjet prioriteteve dhe qëllimeve të vëna për zhvillimin ekonomik të vendit. Gjithashtu, ky program mbështetet në Strategjinë Kombëtare për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020.

Miratimi i këtij projektakti është i paplanifikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Shqipëria po përballlet me sfida në lidhje me sigurimin e cilësisë të sistemeve të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të kanalizimit ndaj qytetarëve. Pavarësisht progresit të vërejtur në vitet e fundit, menaxhimi i ujit dhe kanalizimeve mbetet në një nivel të pakënaqshëm. Aksesit i pamjaftueshëm në ujin higjienikisht të pastër dhe mungesa e shërbimeve të kanalizimit përbëjnë problematikat infrastrukturore kryesore në zonat rurale.

Qeveria shqiptare, me mbështetjen ndërkombëtare, është duke trajtuar këto çështje nëpërmjet programeve të furnizimit me ujë të zonave rurale. Gjatë procesit të përzgjedhjes së programit, u bë një thirrje mbarëkombëtare për aplikime, në mënyrë që të identifikoheshin nevojat më urgjente për ndërhyrje. U identifikuan nevoja të konsiderueshme për investime në qytetin e Himarës dhe në fshatrat fqinje dhe Himara u propozua për t'u shqyrtuar më tej. Sidoqoftë, Himara dhe një listë e gjatë me aplikime të tjera, të ardhura nga e gjithë Shqipëria, nuk mundën dot të zbatoheshin në kuadër të fazës së tretë të programit, për shkak të fondeve të limituara. Kjo është arsyeja pse investimet e nevojshme në Himarë, në fshatrat e saj bregdetare dhe në zonën e Orikumit do të realizohen në kuadër të një programi të ri, të quajtur Ujësjiellësat Ruralë IV.

Për të bërë të mundur financimin e Programit “Ujësjiellësat Ruralë IV”, në kuadër të të cilit parashikohet që nga KfW-ja të akordohet një kredi në vlerën 40 milionë euro dhe një grant në vlerën 2 milionë euro, është nënshkruar marrëveshja qeveritare për bashkëpunimin financiar 2018, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë.

Për arsyet e përmendura më sipër, programi “Ujësjiellësat Ruralë IV” do të zbatohet në një zonë që përfshin Bashkinë Himarë, ku futen qyteti i Himarës dhe fshatrat Kuç, Buronjë (afër Kuç), Pilur, Kudhës, Vuno, Jalë, Livadhi, Himara Fshat, Qeparo e Borsh, vënia në punë e impinatit të trajtimit të ujërave të ndotura të Orikumit, instalimi i lidhjeve familjare për ujësjiellësin në qytetin e Orikumit. Qeveria shqiptare është e interesuar që të zhvillojë koncepte afatgjata për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe të infrastrukturës së kanalizimeve për të gjithë hapësirën e Bashkisë së Himarës dhe Orikumit, me fokus brezin bregdetar. Për këtë arsye, përcaktimi përfundimtar se cilat do të jenë investimet në Himarë do t'i nënshtrohet studimit të fizibilitetit, të financuar nga qeveria Gjermane, studim i cili ka përfunduar në dhjetor 2018.

Bashkia e Himarës konsiderohet si një nga rajonet më të rëndësishme turistike në Shqipëri, me një potencial të madh për zhvillim të mëtejshëm. Gjendet në

bregdetin Jonian të Shqipërisë, rreth 140 km jug - lindje të Tiranës dhe kufizohet në veri me Vlorën dhe në jug me Sarandën. Popullsia totale e bashkisë së Himarës është rreth 25 200 banorë, ndërkohë që numri i turistëve gjatë muajve të verës është 20 000, dhe llogaritet të shkojë deri në 115 000 banorë në vitin 2025. Aktualisht, nga gjetjet e ekspertëve prezumohet që popullsia sezonale të ketë një zhvillim të mundshëm deri në 40 000 banorë, gjë që e cila do të investigohet më tej në studimin e fizibilitetit të sipërpërmendur.

Problematikat që hasen në zonën e Himarës janë të lidhura me faktin se ndërtimi i sistemeve të ujësjellësve të saj datojnë që në vitin 1964. Sistemet ekzistuese të furnizimit me ujë janë në rrjete të vjetra, që shkaktojnë humbje të ujit në shkallë të madhe, dhe puse, me një kapacitet të pamjaftueshëm për kërkesën gjithmonë e në rritje, veçanarisht gjatë pikut të sezonit veror.

Disa komunitete rurale nuk kanë akoma sisteme të furnizimit me ujë, ndërkohë që rritja ekonomike e planifikuar dhe aktivitetet turistike kanë nevojë për zhvillimin e infrastrukturës bazë për furnizimin me ujë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është i bazuar në Kushtetutë dhe është në përputhje me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe është miratuar në parim me vendimin nr.147, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përafron me ndonjë akt ligjor të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/ furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

Me anë të kësaj marrëveshjeje dy qeveritë bien dakord për dhënien e mundësisë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau* (KfW) një kredi të butë, në vlerë të përgjithshme deri në 40 000 000 (dyzet milionë) euro, dhe grant, në vlerën 2 000 000 (dy milionë) euro për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të sipërpërmendur.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Projekti “Furnizimi me ujë i zonave rurale IV” do të zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në cilësinë e agjencisë së zbatimit të projektit.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projekti që do të financohet nëpërmjet kredisë dhe grantit, si më sipër, është parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit - Agjencisë së Zbatimit të Projektit, dhe, më konkretisht, në programin “Furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

KËSHILLI I MINISTRAVE